

Specifikimet Teknike

SPECIFIKIMET TEKNIKE

OBJEKT: "NDERHYRJE RIVITALIZUESE NE SHKALLET E KUZUM BABA-SE"

SEKSION 1.SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

Specifikime të përgjithshme

Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “. “.

Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë supervizorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës.

Informacioni që mban supervizori duhet të përfshijë: vizatime që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të godinës dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai propozon për përdorim; detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme; plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim, detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar si dhe supervizionin epunimeve.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervizori, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervizori gjatë zbatimit të punimeve.

Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

Tabelat njoftuese, etj.

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç:

Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Supervizori dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në anglisht dhe shqip.

REFERENCAT E KODEVE

Analiza dhe kodi struktural i llogaritjeve eshte realizuar sipas

EUROCODE AND TECHNICAL DESIGN CODE si me poshte:

Eurocode 1. Ngarkesat e strukture

Eurocode 2. Dizenjimi i strukturave beton arme, EN 1992.

KARAKTERISTIKAT MEKANIKE TE MATERIALEVE


Projekti struktural per realizimin e punimeve per pllaken e betonit dhe murin per realizimit te pikes panoramike parashikon perdorimin e materialeve me karakteristika mekanike te paraqitura ne paragrafet e meposhtem. Per realizimin e punes ne fjalë do te perdoren materialet e meposhtme:

BETONI

Per la classe di calcestruzzo impiegata per le membrature in elevazione, C25/30 sono riportati i valori di:

- $R_{ck} = 300$ Resistenza cubike me karakteristika te materialeve [daN/cm^2]
- $f_{ck} = 249$ Resistenza cilindrike me karakteristika te materialeve [daN/cm^2]
- $\epsilon_{c2} = 0.002$ Inizio del tratto a tensione costante della legge costitutiva
- $\epsilon_{cu} = 0.0035$ Deformazione ultima del calcestruzzo
- $\gamma_c = 1.5$ Coefficiente parziale di sicurezza allo SLU del materiale
- $\alpha_{cc} = 0.85$ Coefficiente riduttivo per le resistenze di lunga durata
- $f_{cd} = 141.1$ Resistenza cilindrica di progetto del materiale [daN/cm^2]
- $E_{cm} = 314472$ Modulo elastico medio a compressione [daN/cm^2]

Në veçanti, perdoret diagrami parabola-drejt këndësh i paraqitur në figurë



Dallimi në mes të dy klasave qëndron në shtrirjen e plasticizimeve në të cilat i referohet faza e projektimit; për të dy klasat, për të siguruar që struktura të ketë një sjellje disipative dhe duktile duke shmangur thyerjet e brishta dhe formimin e mekanizmave të papritura të paqëndrueshme, bëhet procesi i proceseve tipike të hierarkisë së rezistencës.

Strukturat në fjalë janë hartuar në klasën e duktilitetit (CD) B.

HEKURI PER BETONINE ARMUAR


Per l'acciaio utilizzato, di tipo B450C, sono riportati i valori di:

- $f_y = 4500$ Tensione caratteristica di snervamento [daN/cm^2]
 $f_k = 5175$ Tensione caratteristica di rottura [daN/cm^2]
- f_t
 k

Specifikimet Teknike

- $\epsilon_{uk} = 0.075$ Deformazione ultima caratteristica
- $\gamma_s = 1.15$ Coefficiente parziale di sicurezza allo SLU del materiale
- $f_{yd} = 3913.04$ Tensione di progetto di snervamento [daN/cm²]
- $E_s = 2100000$ Modulo elastico [daN/cm²]
- $\epsilon_{ud} = 0.0675$ Deformazione ultima di progetto
- $\epsilon_{yd} = 0.0019$ Deformazione di snervamento di progetto
- $n = 15$ Coefficiente di omogeneizzazione

In particolare viene utilizzato il modello bilineare incrudente riportato in figura.



KLASA E DUKTILITETIT

Klasa e duktilitetit është përfaqësuese e kapacitetit të strukturës së betonit të armuar për të shpërndarë energjinë në fushën joelastike për veprime ciklike të përsëritura.

Deformimet joelastike duhet të shpërndahen në numrin më të madh të elementeve, veçanërisht të trarëve, duke ruajtur kështu kollonat dhe veçanërisht nyjet e tra-kollone të cilat janë elementët më të brishtë.

Sipas nrmave të ndërtimit edhe të EC8, përcaktohen:

- sjellje strukturore jo disipative;
- sjellje strukturore disipative.

Për strukturat me sjellje strukturore disipative, dallohen dy nivele të Aftësisë Disipative ose Ductility Classes (CD):

- CD 'A' - Lartë;
- CD 'B' - i ulët.

Specifikimet Teknike

DORËZIMET TE SUPERVIZORI

Autorizimet me shkrim

“Rregullat me shkrim ” do t’i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Supervizori të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuar, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohet që aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat instruksionet, emërimet, urdhëresat e Supervizorit do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

Dorëzimet tek supervizori

Kontraktori duhet t’i dorëzojë Supervizorit për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervizori.

Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale,çertifikata testi, kurdo që të kërkojnë nga Supervizori. Supervizori do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t’i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit për të bërë këto pranime.

Mostrat

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhetema të tjera që mund të kërkojnë me të drejtë nga Supervizori për inspektim.

Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e

Supervizorit. Vizatimet e punimeve të

zbatuara dhe librezat e masave

Kontraktori do t’i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të

Specifikimet Teknike

dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI

- **Prishje struktura prej betoni =103 m³**
- **Heqje bordura ekzistuese betoni**
- **12x25cm =600ml**
- **Heqje dyersh me kangjella metalike =20m²**

Prishja e mureve, bordurave do të transportohet brenda kantierit duke u hedhur me karro dore në një gropë që kërkon mbushje në projekt)

Pastrimi i kantierit

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjithë pirgjet e mbeturinave të tjera.

Prishja e mureve

Kontraktori duhet të heqë me kujdes vetëm ato muratura të drejtuara nga Supervizori. Muret. Materialet që janë të ripërdorshme do të mbetë në pronësi të investitorit dhe do të ruhen në vende të veçanta nga kontraktori, derisa të lëvizin prej tij deri në përfundim të kontratës.

Kontraktori, duhet të paguajë çdo dëmtim të bërë gjatë transportit të materialeve me vlerë, të rrethimeve dhe strukturave të tjera dhe nëse është e nevojshme duhet të paguajë kompensim.

Mbrojtja e vendit të pastruar

Kontraktori duhet të ngrejë rrjete të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

PUNIME PRISHJEJE

1. Skeleritë

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e

Specifikimet Teknike

skelerve që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelëtorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeler, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Skeleri celiku të tipit këmbalec, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, më lartësi min. 15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

Skeleri celiku në kornizë dhe e lidhur, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, me lartësi min. 15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

2. Supervizioni

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerve dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

3. Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjetet të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten.

4. Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

- a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet
- b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me eksperiencë
- b) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit

Gjatë punës prishëse të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëseose mjete mbrojtëse si: helmë, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh, dhe bombola frymëmarrjeje.

Specifikimet Teknike

Prishja e elementëve të godinës

1. Prishje mur tulle

Ky ze percakton prishjen e mureve ndares ,pastrimin e tullave dhe transportin e tyre me karo ne vend depozitimin e perkohshem jashte godines.Ne cmimin per njesi jane perfshire ndertimi I skelave,fuqia punetore Per prishje ,transport deri 30 m me karo dore.

2. Prishje shtrese betoni.

Ky ze percakton prishjen e shtreses se betonit prej 10 cm ne dysheme si dhe shkallet ne hyrje dhe transportin e tyre me karo ne vend depozitimin e perkohshem jashte godines.Ne cmimin per njesi jane perfshire,fuqia punetore per prishje si dhe transporti deri 30 m me karo dore.

3. Heqja e dyerve dhe dritareve

Heqje dyersh dhe dritaresh, që realizohet para prishjes së murit, duke përfshirë kasën, telajot,etj Sistemimin e materialit që ekziston brenda ambientit të kantierit dhe grumbullimin në një vend të caktuar në kantier për ripërdorim.

4. Transport mbeturina me auto

Ky ze perfshin grumbullimin,ngarkimin dhe transportin e mbeturinave me karro dore.



Dyert - informacion i përgjithshëm

Ne objekt janë 2 porta metalike që do të prishen dhe do të rindertojnë perseri dhe një porte e cila do të prishet dhe nuk do të ndertohet perseri.

Dyert - Vendosja në vepër

Vendosja e dyerve në vepër duhet të bëhet sipas kushteve teknike për montimin e tyre të dhëna në standartet shtetërore. Mënyra e vendosjes së tyre është në varësi të llojit të

derës dhe materialit që përdoret për prodhimin e tyre. Për secilin prej llojeve të dyerve vendosja në vepër duhet të bëhet si më poshtë:

Shkulje rrenjeve bimeve te vogla

Ky çmim përfshin pastimin nga bimësia e ulët. Vegetacioni i ulët ka nevojë për ndërhyrje në të dyja ciklet e zhvillimit, pranverë dhe vjeshtë. Trajtimi i tij do të bëhet në bazë të aspektit të zhvillimit. Në strukturat ku vegetacioni është i rrallë do të përdoret pastrimi mekanik i tij, duke e eliminuar vegetacionin me githë rrënjë. Pas eliminimit përfundimtar të vegetacionit, është e nevojshme që të bëhet fugatimi i muraturës. Në rastet kur trangu/kërçelli ka diametër më të madh se 4 cm atëherë pasi të bëhet prerja do të përdoret mënyra e injektimit të herbicidit si tek pemët e larta.

Ky çmim është për njësi Lekë/m².

Hedhje, rafshim, mbushje dheu (per realizimin e bazamentit te shkales se re dhe kalldremi ne zonen ku mbaron)

Ky zë parashikon nivelimin e sipërfaqeve përpara hedhjes së shtresave të sheshit. Ky sistemim nënkupton:

1. Mbushje

Mbushja konsiston në hedhjen e një shtrese dherash të specifikuara brenda zonave të gërmuara në formë shtresash për të krijuar një shtresë homogjene. Nivelimi nga ana tjetër konsiston në vendosjen e materialit mbushës në formë shtresash derisa të arrihet niveli i përcaktuar për secilën nga zonat.

2. Kompaktësim

Kompaktësimi i dherave për mbushje dhe nivelimi do të kryhet me përdorimin e pajisjeve të specifikuara që janë të përshtatshme për tokën që i nënshtrohet ngjeshjes dhe për zonën e punës. Kompaktësimi i dherave do të kontrollohet gjatë ndërtimit që të jetë në përputhje me densitetin e specifikuar për çdo zonë.

3. Nivelim

Të gjitha zonat brenda kufijve të përcaktuar por edhe zonat e afërta tranzicionale duhet të nivelohen në mënyrë uniforme. Sipërfaqja e përfunduar duhet të jetë e ngjeshur, e sheshtë brenda tolerancave të specifikuara dhe mos ketë parregullsi sipërfaqësore.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/m³.

PUNIME MURATURE

Mur guri në lartësi deri 3m me llaç gëlqere 1 : 3

Ky çmim përfshin realizimin e murit me gurë. I gjithë ky proces do të bëhet pasi të kemi sistemuar terrenit ekzistues.

Pasi të kemi bërë sistemimet e nevojshme do të vazhdojmë ngritjen e muraturës duke përdorur gurë të cilët fillimisht i kemi pastruar, si edhe plotësimin e muraturës me gurë të marrë nga burime të afërta. Muri mbajtet do të punohet me llaç gëlqere 1:3.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

Specifikimet Teknike

Restaurim Mur guri ne lartesi deri 3m

Restaurim muri guri me llaç gëlqere 1:3, konsiston ne kontrollin e mureve te demtuar , plotesimin e gureve qe mungojne, ose zevendesimin e gureve te demtuar te ngjajshem me ta. Do të aplikohet zëvendësimi i materialit të gurit të dëmtuar me material të ri me të njëjtin litotip duke siguruar integritetin e muraturës. Përforcimi i mureve, të cilët pasi të jetë bërë pajantimi do të ndërhyet pjesë-pjesë çdo 1 metër.

Në këtë çmim përfshihet blerja e transporti i të gjitha matrialeve të nevojshme dhe çdo gjë që lidhet me këtë proces. Pastrim I fugaturave dhe gureve ekzistues.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.




Gabiona me rrjet teli te zin, gure kave 1*2*1.5

Specifikimet Teknike

në objekt. Në çmim përfshihet, blerja, transporti dhe çdo gjë që lidhet me të.
Ky zë jepet për një ton hekur të mbaruar.

2.182 F V konstruksione metalike te thjeshta

Ky zë përfshin vendosjen e hekurit për zgarat e përdorura për devijimin e ujit në kuneta dhe për realizimin e stolave.



STRUKTURAT METALIKE

Të dhëna të përgjithshme

Në projektimin e konstruksioneve prej çeliku, duhen marrë parasysh kërkesat që pasqyrojnë veçoritë e punës së këtyre konstruksioneve, më anë të udhëzimeve përkatëse në mbështetje të këtyre kushteve teknike.

Soliditeti dhe qëndrueshmëria e konstruksioneve prej çeliku duhet të garantohet si gjatë procesit të shfrytëzimit, ashtu edhe gjatë transportimit dhe montimit.

Prodhimi

Prodhimi i çelikut duhet të jetë bërë nga kompani të licensuara dhe ata duhet të garantojnë për cilësinë si dhe të dhënat (përbërja kimike, karakteristikat e forcës/bajtëse, etj) e çelikut.

Çeliku që përdoret për konstruksionet mbajtëse, duhet t'u përgjigjet kërkesave të standarteve dhe kushteve teknike përkatëse dhe të ketë garanci përse i përket kufirit të rrjedhshmërisë dhe përmbajtjes max. të squfurit dhe fosforit; kurse për konstruksionet e salduara, edhe për përmbajtjen max. të karbonit.

Prerja, saldimi si dhe lidhja e elementeve prej çeliku bëhet në kantierin e firmës kontraktuese dhe ata transportohen në kantier ose këto punime mund të bëhen në vëndin e punës (në objekt).

Sidoqoftë, duhet që punimet para montimit të elementeve të kontrollohen nga Supervizori dhe duhet të

Specifikimet Teknike



Sipas projektit ka një rreshkitje të rrugës e cila do të zgjedhet duke ndërtuar mur me gabion të zingëruar me gur kave. gjerësia e murit në bazament duhet të jetë sa lartësia e murit.

Vendi ku do të ndërtohet ka vështirësi për transportin e materialeve pasi nuk ka rrugë makinash.

PUNIME HEKUR BETONI DHE B/A

Përgatitje hekur betoni i zakonshëm Ø 6 - 10 mm

Përfshihet përgatitja e çelikut për të gjitha strukturat e betonit dhe komponentët e metalit, që duhen prodhuar në kantier, duke konsideruar çelikun që plotëson të gjitha kërkesat e projektit dhe pa prezencën e ndryshkut, në format dhe përmasat sipas vizatimeve dhe standarteve tekniko - legale për bashkimin, lidhjen dhe duke e shoqëruar me çertifikatën e prodhuesit për të verifikuar që çeliku plotëson kushtet e kërkuara që nevojiten për punë të tilla dhe duke përfshirë të gjitha kërkesat e tjera jo të specifikuara.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet të bëhet për përgatitjen, kthimin, lidhjen e hekurit dhe vendosjen në objekt. Në çmim përfshihet, blerja, transporti dhe çdo gjë që lidhet me të.

Ky zë jepet për një ton hekur të mbaruar.

2.166/1a. Përgatitje hekur betoni i zakonshëm Ø > 12 mm

Përfshihet përgatitja e çelikut për të gjitha strukturat e betonit dhe komponentët e metalit, që duhen prodhuar në kantier, duke konsideruar çelikun që plotëson të gjitha kërkesat e projektit dhe pa prezencën e ndryshkut, në format dhe përmasat sipas vizatimeve dhe standarteve tekniko - legale për bashkimin, lidhjen dhe duke e shoqëruar me çertifikatën e prodhuesit për të verifikuar që çeliku plotëson kushtet e kërkuara që nevojiten për punë të tilla dhe duke përfshirë të gjitha kërkesat e tjera jo të specifikuara.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet të bëhet për përgatitjen, kthimin, lidhjen e hekurit dhe vendosjen

Specifikimet Teknike

protokollohen.

Saldimi

Përgatitja për saldim përfshin atë që detajet para se të saldohen, të kenë marrë formën e tyre përfundimtare. Po ashtu, buzët dhe sipërfaqet e pjesëve që do të saldohen duhet të përgatiten sipas kërkesave të procedurës së saldimit dhe formave që jepen në pasqyrat 6,7,8 të K.T.Z. 206-80 ose në ndonjë tjetër normë/standart evropian.

Pas saldimit, detajet duhet të trajtohen termikisht për të zvogëluar ndarjet e brendshme, për të mënjanuar të plasurat dhe për të përmisuar vetitë fiziko-mekanike.

Gjatë zbatimit të punimeve për saldimin e çelikeve duhet të mbahet dokumentacioni teknik më të dhëna për çertifikatën e materialeve të përdorura, ditarin e punimeve, etj.

Mbrojtja nga agjentët atmosferikë

Mbrojtja e çelikut bëhet në dy mënyra:

Duke e lyer çelikut me disa shtresa, të cilat e mbrojnë çelikut prej korrosionit. Ajo bëhet duke e lyer, zhytur ose duke e spërkatur me shtresa. Njëra shtresë është baza, kurse shtresa tjetër përdoret edhe si dekorim i elementit dhe mund të ketë ngjyrë të ndryshme.

Materiali në të cilin do të vendosen shtresat duhet më parë të përpunohet dhe të jetë i lirë nga pluhuri, vaji si dhe nga ndryshku.

Shtresë prej metali: kjo mbrojtje është e përhershme. Çeliku duhet zhytur në zink të nxehtë (450 °C) dhe sipërfaqja e tij të jetë e lirë prej pluhurit, vajit si dhe prej ndryshkut. Përmbi atë, mund të vendoset ndonjë shtresë tjetër si dekorim i elementit prej çeliku (si psh. bojë).

Ky çmim jepet për njësi Lekë/m².

PUNIME SHITESASH

Hedhje, rafshim, mbushje dheu (Ky ze do të përdoret për realizimin e bazamentit për skallen e re dhe kalldremin e ri)

Ky zë parashikon nivelimin e sipërfaqeve përpara hedhjes së shtresave të sheshit. Ky sistemim nënkupton:

2. Mbushje

Mbushja konsiston në hedhjen e një shtrese dherash të specifikuara brenda zonave të gërmuara në formë shtresash për të krijuar një shtresë homogjene. Nivelimi nga ana tjetër konsiston në vendosjen e materialit mbushës në formë shtresash derisa të arrihet niveli i përcaktuar për secilën nga zonat.

3. Kompaktësim

Kompaktësimi i dherave për mbushje dhe nivelimi do të kryhet me përdorimin e pajisjeve të specifikuara që janë të përshtatshme për tokën që i nënshtrohet ngjeshjes dhe për zonën e punës. Kompaktësimi i dherave do të kontrollohet gjatë ndërtimit që të jetë në përputhje me densitetin e specifikuar për çdo zonë.

Specifikimet Teknike

4. Nivelim

Të gjitha zonat brenda kufijve të përcaktuar por edhe zonat e afërta tranzicionale duhet të nivelohen në mënyrë uniforme. Sipërfaqja e përfunduar duhet të jetë e ngjeshur, e sheshtë brenda tolerancave të specifikuara dhe mos ketë parregullsi sipërfaqësore.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/m².

Nënshtresë zhavori

Ky zë përfshin blerjen e materialit të zhavorrit, si dhe vendosjen në vepër. Shtresa e zhavorrit është parashikuar të vendoset në të gjithë sipërfaqen që do të realizohet kuneta. Do të bëhet ngjeshja dhe nivelimi i shtresës.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

Shtresë rëre

Ky zë përfshin blerjen e materialit të rërës si dhe vendosjen në vepër. Shtresa e rërës është parashikuar të vendoset si shtresë për vendosjen e kalldrëmit. Do të bëhet ngjeshja dhe nivelimi i shtresës.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

Shtresë kalldrëmi 15-20 cm mbi shtresë rëre

Do të bëhet shtrese kalldrëmi e re sipas vizatimit. Këto punë do të bëhen në këtë mënyrë:

Përmbi bazën do të vendohet një shtresë rëre me një trashësi maksimale prej 5 cm mbi të cilën do të vendosen gurët e kalldrëmit. Shtresa e rërës duhet të jetë me kokrriza 2/5 mm deri 0/4 mm. Ajo do të rrafshohet dhe mbi atë duhet të vendosen gurët e kalldrëmit.

Mbas vendosjes do të tunden në atë mënyrë që të arrihet një rrafshësi perfekte. Më në fund fugat do të mbushen me një rërë të imët 0/1 mm në atë mënyrë që të bëhet lidhja me njëra me tjetrën dhe të përforcohet/stabilizohet shtresa e kalldrëit.

Projektuesi së bashku me Mbikqyrësin e punimeve duhet të bien në marrëveshje ndaj modelit, dimensioneve dhe ngjyrës së pllakave, dhe të sigurohen që janë të ngjashme me ato ekzistuese.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

R.66 Restaurim kalldrëmi 15-20 cm

Restaurimi i kalldrëmit në pjesët ku evidentohen mungesa (sipas fletëve grafike), do të realizohet me gur, si gurët original ekzistues. Shtresat që do të përdoren do të jenë, shtresë dheu i ngjeshur (mundësisht të ngopet me ujë para së të kalohet në nguljen e gurëve), me një trashësi deri në 30 cm mbi të cilën do të ngulen gurët e kalldrëmit. Ngulja e gureve do të bëhet duke i ngjeshur mirë pranë njeri tjetrit, dhe mbushja me një shtrese rëre lumi të pa situar dhe të pa larë më parë. Kujdes duhet të bëhet me kuotat për largimin e ujërave sipërfaqësore.

do të aplikohet në rastet kur pllakat e dyshemesë paraqesin disnivele, apo çarje të formatit të tyre. Në raste të tilla, do të ndërhyhet me heqjen e pllakave, nivelimin dhe ngjeshjen me tokmak të sipërfaqes së truallit ku qendrojnë dhe më tej, rivendosjen e tyre direkt në truall pa shtesë lidhëse, në përputhje me sipërfaqen.. Për pllakat e çara, të shihet mundësia e riparimit me anë të pastrimit dhe përputhjes së buzëve bashkuese si dhe ngjitjes, kur është e mundur. Zëvendësimi i materialit guror të bëhet vetëm me material të njëjtë me atë ekzistues (vetëm në rast kur mungon totalisht).

Në çmim përfshihet, gjithëcka duhet për përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe jepet për njësi Lekë/m².

Specifikimet Teknike

Shtresë betoni C 12/15

Shtresa e betonit do të vendoset në pjesën e oborrit. Ky zë përfshin të gjithë materialin e nevojshëm betoni të varfër C12/25 për shtrim, transportin dhe vendosjen në vepër.

Shtresa e betonit do të vendoset në pjesën e oborrit. Ky zë përfshin të gjithë materialin e nevojshëm betoni të varfër C12/25 për shtrim, transportin dhe vendosjen në vepër.

Shtresë llustër çimento 1:2

Gërmimi i dheut duhet të bëhet më së pakti deri në një thellësi prej 30 cm nga toka për një gjerësi sipas planeve të bëra. Pastaj duhet vendosur një shtresë zhavori me trashësi prej 20 cm e cila duhet ngjeshur dhe sheshuar mirë. Përsipër asaj vendoset një shtresë prej betoni M 150 me një trashësi prej 10 cm me fuga teknike çdo 3 m, e formuar me shtresa të holla dhe të vibruara mirë. Shtresa me llaç çimentoje 2:1 me trashësi minimale 2 cm, duhet lëmuar dhe sheshuar në mënyrë perfekte, duke përfshirë kallëpet, përforcimet, si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës me cilësi.

Ky çmim jepet për njësi Lekë/m².



Ndërtim shkallë guri

Shkalla e gurit do të ndërtohen në pjesën e rrugës që është demtuar nga rreshqitja sipas projektit. Do të vijohet me ndërtimin e shkallës së gurit ku shkalla do të jetë e llogaritur si një bllok i plotë guri, me $h=20$ cm sipas specifikimit në fletët teknike. Materiali i gurit duhet të jetë i punuar përpara se të vendoset në objekt, dhe me karakteristika të njëjta me materialin e gurit të përdorur në objekt për shkallët ekzistuese. Shkallët do të kufizohen

Specifikimet Teknike

nga muri i gurit.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m

Suva e zakonshme fasade mur tulle llaç gëlqere 1:2

Sipërfaqja e suvatuar do të kontrollohet e gjitha duke evidentuar suvatimin e shkëputur, i cili do të prishet deri në gur. Do të evidentohen çarje të mundshme në fasadë. Fasadat do të lahen me ujë të bollshëm duke pastruar sipërfaqen nga pluhurat. Fillimisht do të kryhen stukimet, qepjet e çarjeve të mundshme dhe sistemimi i sipërfaqeve ku është i nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç gëlqere 1:2 me më shumë shtresa edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin. Përpara se të vendoset shtresa e suvasë duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Llaçi i suvasë nuk duhet të aplikohet në $t_m \leq 5^\circ\text{C}$.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2cm llaçi gëlqere 1:2 i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirit me llaç me trashësi 15cm çdo 1 deri në 1,5m), dhe e lëmuar me mistri e përdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Llaç gëlqere ajrore duhet të ketë këto karakteristika :

- ❖ ***Kufiri i rezistencës në shtypje 25 kg/cm²,***
- ❖ ***Pesha volumore 1800 kg/m³,***
- ❖ ***Konsistenca, ≤ 8***
- ❖ ***Papastërtia e rërës 12 %,***
- ❖ ***Moduli, 1.8***
- ❖ ***Raporti G:R 1:2***

Rëra për suva duhet të jetë e përbërë nga kokriza të dimensioneve të tilla për të kaluar në sitë me përmasa 1mm. Në këtë zë punimesh përfshihen çmimet që duhen për të realizuar sipas kushteve teknike riparimet e suvatimeve të mureve të jashtëm guri, përgatitja e sipërfaqes së murit pastrimi nga pluhuri, lagja, vendosja e shtresës së suvasë deri në tharje, dora e dytë, dhe finoja, skeleritë e nevojshme. Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme me cilësi, transporti i tyre, skeleri, përpunimi dhe vendosja në objekt, ngarkim shkarkimi dhe çdo punë që lidhet me të.

Ky çmim është për Lekë/ m².

Restaurim fasade me pllaka guri

Fragmentet e mureve ekzistuese të murit që janë në gjendje të degraduar ose kanë nevojë për plotësim do t'i nënshtrohen procesit të restaurimit. Do të zbërthehen vetëm pjesët shumë të dëmtuara si pjesë e procesit të konsolidimit. Këto pjesë do të restaurohen. Prishja do të bëhet pjesë-pjesë dhe mbas prishjes së një pjese.

Ky proces do të kryhet në prezencë të mbikqyrësit të punimeve restauruese, si një proces delikat, ku do të gjykohet dhe trajtimi pjesë pjesë i murit të hyrjes nëpërmjet konsolidimit të materialit ekzistues me llaç M15, fugatimit dhe zbërthimit e zëvendësimit të materialit të gurit nëse shikohet e domosdoshme. Do të verifikohen paraprakisht karakteristikat fizike e

Specifikimet Teknike

mekanike të murit dhe të elementëve të gurit (materiali, spesori, mënyra e lidhjes së elementëve). Do të analizohet shkalla e degradimit të strukturës.

Me tej pjesë-pjesë pasi pastrohet nga mbeturinat do të fillojë plotësimi i murit. Materiali i gurit do të jetë i punuar, i njëjtë me gurët ekzistues, ngjyra dhe madhësia e tyre po ashtu. Lidhja midis gurëve do të bëhet me llaç M15.

Ky çmim është për Lekë/m'.

Fugatim muri (pastrim mekanik+larje me ujë+fugatim)

Fugatime do të kryhen në ato raste kur çarjet (fisurat) janë deri të një madhësie mesatare dhe kur vërehet se llaçi ekzistues është i degraduar. Fugatime sipërfaqësore do të aplikohen në ato raste kur çarjet janë të karakterit kapilar me qëllimin e vulosjes së tyre.

Fugatimet konsistojnë në pastrimin e llaçit ekzistues të dëmtuar.

Fugatimi do të fillojë me pastrimin mekanik (gërryerjen) të fugave nga llaçi degraduar. Pas pastrimit mekanik të fugës dhe larjes me ujë të bollshëm do të kryhet mbyllja e fugave. Masa e llaçit të përgatitur, duhet të jetë homogjen dhe uniform. Fugatimi do të kryhet me llaç gëlqerë të majmë, me konsistencë të ulët. Mbasi fillon prezën llaçi, atëherë ai laget dhe fërkohet me furçë teli për të eliminuar plasaritjet eventuale të tij. Është e rëndësishme të bëhen analiza të miratuara, për të mësuar përbërjen kimiko-fizike të llaçit ekzistues në mënyrë që të përcaktosh qartësisht natyrën, prejardhjen dhe granulometrinë e materialit të përdorur. Përbërja e llaçit duhet të jetë me material analog të atij ekzistues. Përbërja e llaçit të fugave do të pranohet nga mbikqyrësi i punimeve pas provave dhe marrjes së kampionëve në vend dhe nga rezolucioni kromatik që duhet të arrihet në ngjashmëri me llaçin ekzistues. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin dhe heqjen e kujdesshme të shtresës së llaçit në fugat me furçë teli të ashpër dhe largimin e mbeturinave nga objekti, transporti i materialeve dhe gjithcka duhet për përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim është për njësi Lekë/m².

R.110 Bojë hidroplastike

Para lyerjes duhet të bëhet kruajtja e ashpër e shtresës së bojës së mëparshme nga sipërfaqja e murit, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit dhe bërja gati për paralyerje. Përpara fillimit të procesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Më parë bëhet lyerja me astar dhe më pas do të bëhet lyerja dy duar me bojë të cilësisë së I-rë. Ngjyra do të përcaktohet nga mbikqyrësi i punimeve në rast se në projekt nuk është e përcaktuar ose në rast se është e paqartë.

Ky çmim përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe jepet për njësi Lekë/m².

Mbushje me cakell pas mureve

Mbjellje bari


Në fund të punimeve, pjesët ku territori nuk është i shtruar me pllaka guri ose në zonat ku mungon ose është dëmtuar gjatë punimeve në objekt, do të mbillet tapet bari me rritje mesatare.

Specifikimet Teknike

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m².

Hartuan :

Ing. Ana Celaj



DREJTUES

Zambak Selmani

